

OBJEKTI: RIKONSTRUKSIONI I GODINES SE BASHKISE MEMALIAJ



Per Sektorin e Zhvillimit Urban dhe Kadastres

**Ing. Violeta Kanushi
Topo. Petrit H. Hoxha**

**Miratohet
Kryetari
DURIM RROSHI**



BASHKIA MEMALIAJ

**Per C.E.C Group
Ing. Vangjush Mbrice
Ing. Anduen Mbrice**



RAPORTI TEKNIK

Relacion Teknik

Objekti: "Rikonstruksioni I godines se Bashkise Memaliaj",
Bashkia Memaliaj

1. Te pergjithshme

Qëllimi i detyrës se projektimit është:

Projektimi i ndërhyrjes ndertimin e dy fushave sportive ne Bashkinë Memaliaj.

Zona Gjeografike: Memaliaj kufizohet në veri me bashkinë Mallakstër, në lindje me bashkinë Këlcyrë, në jug me bashkinë Tepelenë dhe në perëndim me bashkinë Himarë dhe Selenicë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Memaliajt.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia ka një popullsi prej 10.657 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrat Civil, kjo bashki ka 21.476 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 372.07 km² me një densitet prej 78.90 banorë/km².

Kjo bashki përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Memaliaj, Memaliaj Fshat, Luftinjë, Buz, Krahës dhe Qesarat. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit Tepelenë dhe e qarkut Gjirokastrë. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 53 fshatra. Për të parë listën e plotë të qyteteve dhe fshatrave të kësaj bashkie

Projekti është hartuar në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi siguron respektimin e standardeve edhe gjatë zbatimit.

2. Gjendja aktuale e ndertimit

Godina e bashkise Memaliaj ndodhet ne afersi te sheshit kryesor te qytetit.

Ne kushtet e sotme godina e bashkise ndodhet ne nje gjendje jo te mire nga pikepamja estetike dhe funksionale. Nga pikepamja strukture kjo godine nuk shfaqen probleme te medha.

Problemet me te medha qe has kjo godine kane te bejne me lageshtiren, renien ose prishjen e pothuajse te gjithe suvtimeve. Gjithashtu rrjeti elektrik eshte tejet i amortizuar dhe ka nevojë per nderhyrje urgjente.



ope
Procurement
Albania



Fig. 1 Pamje nga gjendja ekzistuese

3. Nderhyrjet qe do te behen ne Objekt


Qellim i ketij projekti eshte te krijohen kushte te pershtatshme per mirefunksionimin e kesaj godine. Perfistuesit kryesore do te jene punonjesit e bashkise dhe te gjithe qytetaret e bashkise Memaliaj.

Ne si projektues kemi parashikuar qe te behet hidroizolimi nga e para e gjithe godines, tarraca e dysHEME dhe te behet shtrimi me pllaka ne te gjithe siperfaqen e godines. Gjithashtu kemi parashikuar qe te prishen te gjitha suvatimet dhe te behen te reja ne te dy katet e godines. Ne katin e dyte me propozimin e projektuesit dhe me me miratimin e stafit te bashkise eshte bere nje ndryshim ne planimetri, duke e ndare nje ambient te madh ne dy ambiente te vecanta me te vogla, te cilat do te perdoren sipas nevojave te bashkise.

Gjithashtu eshte menduar qe te sistemohet sheshi para bashkise, duke bere shtrimin e tij me asphalt, si dhe nje trotuar me gjeresi 60cm te shtruar me pllaka betony.

Shtresat e sheshit do te jene:

Asfaltobeton	3cm
Binder	4cm
Stabilizant	15cm
Shtrese cakulli	10cm



Per "C.E.C GROUP" sh.p.k

Ing. Vangjush MBRIÇE

Ing. Anduen MBRIÇE